



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2018:019814

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05450943

P.nr.147/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja e vetme gjykuese Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen penale ndaj të akuzarve: **T. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, T. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, A. Q. nga fshati..., Komuna e Dragashit dhe K. Sh. nga fshati..., Komuna e Dragashit**, për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1406-6/16 të dt. 16.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor – fjalës përfundimtare të palëve, me datë 21.02.2024 në prani të prokurorit të shtetit nga Prokuroria Themelore në Prizren, prokurorit Musli Gashi, të pandehurve **T. K. me mbrojtësin e tij av. A. R., A. Q. me mbrojtësin e tij av. S. B., K. Sh. me mbrojtësin e tij M. S. dhe i pandehuri T. K. me mbrojtësin e tij av. S. B., të gjithë nga Dragashi** mori ndërsa me datë 13.03.2024 përpiloi edhe këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

1. T. K., nga i ati I. e ëma R. e lindur B., i lindur me dt..., në fshatin..., Komuna e Dragashit, ku dhe tani jeton ka të mbaruar shkollën fillore, i martuar, babai i dy fëmijëve, punëtor i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal...

2. K. SH., nga i ati F. e ëma S. e lindur K., i lindur me dt..., në fshatin..., Komuna e Dragashit, ku dhe tani jeton ka të mbaruar shkollën fillore, i martuar, babai i tre fëmijëve, punëtor i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal...

3. T. K., nga i ati H. e ëma N. e lindur Q., i lindur me dt..., në fshatin..., Komuna e Dragashit, ku dhe tani jeton ka të mbaruar shkollën fillore, i pa martuar, punëtor i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal...

4. A. Q., nga i ati M. e ëma A., e lindur D., i lindur me dt..., në fshatin..., Komuna e Dragashit, ku dhe tani jeton ka të mbaruar shkollën e mesme, i martuar, babai i gjashtë fëmijëve, punëtor-bujk i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal...

Bazuar në nenin 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPP-së:

REFUZOHET AKUZA

Se me dt.25.11.2015, rreth orës 18:10 min. në fsh..., Komuna e Dragashit në shtëpinë e të dëmtuarit H. M., në bahskë veprim, duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në hapësirat e mbyllura ose duke hequr pengesa tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme në atë mënyrë që shfrytëzojnë momentin e volitshëm, mos prezencën e të dëmtuarës, i afrohen shtëpisë së të dëmtuarës, ku me mjetë përshtatshëm dhe me forcë e hapin dritaren e dhomës së fjetjes, hynë brenda duke kontrolluar e demoluar dhomën, ku nga aty marrin stoli të arit si: 4 zingjir të qafës, 2 hallka të dorës, 2 krahërore, 1 pesë lirësh, 4 lira, 5 qerek lira, 1 qystek, 3 palë vathë, 1 komplet të arit, 1 zingjir me rrumbullak, 8 unaza, 1 pllakë ari, 1 shkronjë "E" e arit, stoli të argjendit 1 komplet (zingjir, krahërore, hallkë, 2 unaza, vath), 2 hallka të argjendit si dhe disa bizhuteri, të gjitha në vlerë prej 7.000,00 (shtatë mijë euro) € dhe largohen nga vendi i ngjarjes me ç'rast të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material.

-Me çka në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 nënparag. 1.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

- Për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit nga ndjekja penale.

Të dëmtuarit: H. (E.) M. dhe V. B., që të dy nga fshati..., Komuna e Dragashit, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, me aktakuzën PP/II.nr.1406-6/16 të datës 16.11.2017 ka akuzar të pandehurit: T. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, T. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, A. Q. nga fshati..., Komuna e Dragashit dhe K. Sh. nga fshati..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale, vjedhje e tëndë nga neni 327 paragrafi 1, nënpar. 1.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Prokurori i shtetit Elfete Purova në fjalën e saj përfundimtare, dorëzuar kësaj gjykate me shkrim me dt. 21.02.2024, ka deklaruar se tërhiqet nga ndjekja penale ndaj të akuzuarve, pasi që duke u bazuar në të gjitha faktet e kësaj çështjeje penale dhe pas administrimit të të gjitha provave konstaton se nuk është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të kësaj Aktakuze, për këtë në mungesë të provave tërhiqet nga Aktakuza në bazë të nenit 362 par. 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së dhe i ka propozuar gjykatës që të merr Aktgjykim refuzues ndaj të pandehurve nga aktakuza.

Pasi që prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarve gjykata bazuar në nenin 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPP-së, ka marr aktgjykim me të cilin e ka refuzuar akuzën.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarëve në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore - juridike, është marë konform nenit 462 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës është marrë bazuar në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:019814, 14.03.2024

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.